



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË



Data 17/07/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shpenzime për blerje automjeti Pick-up”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Automjete 34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,745,980 (tre milion e shtatëqind e dyzet e pese mijë e nentëqind e tetëdhjetë) lekë, pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Korçë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor **jo më vonë se data 31 mars** e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës të perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës të perlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", si dhe Udhëzimin e ministries së transportit dhe infrastruktures me nr.1546, datë 29.03.2016. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i caktuar me udhërin e Nr. 701 datë 15.06.2026 sipas procesverbalit të mbajtur prej tij.

Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mjetit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë mjet i cili do të ndihmojë NSHP në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në respektim të nenit 36 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Konkretisht:

1. Pick up duhet të jetë me të gjitha pajisjet standarde normale dhe i gatshëm për punë.

Argumentim teknik: Kërkesa synon sigurimin e furnizimit me një mjet të kompletuar dhe funksional, i cili të mundësojë përdorimin e menjëhershëm për qëllimin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pa nevojën për investime apo pajisje shtesë pas marrjes në dorëzim. Pajisjet standarde të prodhuesit garantojnë sigurinë, komoditetin dhe funksionalitetin operacional të mjetit.

2. Karakteristikat e sigurisë së sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit dhe të gjitha pajisjeve/aparaturave duhet të jenë funksionale dhe konform standardeve të Bashkimit Europian.

Argumentim teknik: Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me garantimin e sigurisë së përdoruesve të mjetit dhe të personave të tjerë në rrugë. Sistemet e frenimit, drejtimit dhe ndriçimit janë elementë kritikë për funksionimin e sigurt të automjetit, ndaj kërkohet që mjeti të jetë në përputhje me standardet teknike europiane dhe kërkesat e sigurisë rrugore.

3. Kabina duhet të jetë dopio, konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem ngrohjeje dhe ftohjeje.

Argumentim teknik: Kabina dopio është kërkuar për të mundësuar transportin e një numri më të madh të personelit të shërbimit dhe për të rritur efikasitetin operacional gjatë punëve në terren. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes siguron kushte të përshtatshme pune për drejtuesin dhe pasagjerët në kushte të ndryshme klimatike, duke garantuar komoditet dhe siguri gjatë përdorimit.

4. Numri i dyerve: 4.

Argumentim teknik: Kërkesa për katër dyer lidhet me konfigurimin e kabinës dopio dhe mundëson akses më të lehtë dhe të sigurt për drejtuesin dhe personelin shoqërues. Ky konfigurim është i përshtatshëm për mjetet që përdoren për shërbime operative dhe inspektime në terren.

5. Mjeti të jetë jo më i vjetër se viti 2017.

Argumentim teknik: Kufizimi i vitit të prodhimit synon garantimin e një jetëgjatësie të mjaftueshme teknike, uljen e kostove të mirëmbajtjes dhe sigurimin e një mjeti me parametra bashkëkohorë të sigurisë, konsumit të karburantit dhe standardeve të emetimeve. Një mjet më i ri garanton besueshmëri më të lartë në përdorim dhe redukton rrezikun e defekteve gjatë operimit.

6. Lënda djegëse: Naftë.

Argumentim teknik: Motorët me naftë janë të përshtatshëm për automjete Pick Up që përdoren për punë operative dhe transport në terrene të ndryshme, pasi ofrojnë çift rrotullues më të lartë, eficiencë më të mirë në ngarkesa dhe përshtatshmëri për përdorim intensiv.

7. Transmision manual me reduktor 4x4.

Argumentim teknik: Sistemi 4x4 me reduktor është kërkuar për të garantuar aftësi të lartë lëvizjeje në terrene të vështira, rrugë të pashtuara, zona rurale apo kushte të pafavorshme atmosferike. Reduktori mundëson transmetim më të madh të fuqisë në shpejtësi të ulëta, duke rritur kapacitetin tërheqës dhe sigurinë e përdorimit.

8. Xhamat e dyerve të para me hapje-mbyllje elektrike.

Argumentim teknik: Kjo kërkesë siguron lehtësi në përdorim dhe rrit standardin e funksionalitetit të mjetit, duke mundësuar komandim të shpejtë dhe të sigurt nga drejtuesi i automjetit.

9. Masa e mjetit bosh jo më pak se 2100 kg.

Argumentim teknik: Masa minimale e kërkuar lidhet me nevojën për një mjet të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për punë operative, transport pajisjesh dhe ngarkesash. Pesa më e lartë siguron stabilitet më të mirë gjatë lëvizjes, veçanërisht në terrene të vështira dhe gjatë përdorimit me sistemin 4x4.

10. Motori me naftë, ftohje me lëng, fuqi jo më të vogël se 105 kW.

Argumentim teknik: Fuqia minimale e motorit është përcaktuar për të garantuar performancën e nevojshme të mjetit gjatë transportit, përdorimit në terrene të ndryshme dhe gjatë mbajtjes së ngarkesave. Sistemi i ftohjes me lëng garanton funksionim të qëndrueshëm të motorit edhe gjatë përdorimit intensiv.

11. Vëllimi i motorit jo më i vogël se 2200 cc.

Argumentim teknik: Kapaciteti minimal i motorit është kërkuar për të siguruar fuqi të mjaftueshme, jetëgjatësi mekanike dhe performancë të qëndrueshme në kushte pune operative. Motorët me këtë kapacitet janë të përshtatshëm për automjete Pick Up me konfigurim 4x4 dhe përdorim në terrene të ndryshme.

12. Numri i cilindrave jo më pak se 4.

Argumentim teknik: Motorët me minimum katër cilindra ofrojnë balancim më të mirë, qëndrueshmëri mekanike dhe performancë të përshtatshme për një automjet pune, duke garantuar funksionim të besueshëm dhe jetëgjatësi.

13. Pajisur me ABS, ESP, ESC, goma të gjitha stinëve dhe gomë rezervë.

Argumentim teknik: Këto pajisje janë kërkuar për rritjen e sigurisë aktive dhe pasive të automjetit. Sistemet ABS, ESP dhe ESC përmirësojnë kontrollin e mjetit gjatë frenimit dhe manovrimeve, ndërsa gomat e përshtatshme dhe goma rezervë sigurojnë vazhdimësinë e përdorimit dhe sigurinë gjatë operimit.

14. Mjeti duhet të jetë me dokumentacion të rregullt dhe i targuar sipas standardeve të DPSHTRR.

Argumentim teknik: Kërkesa synon që mjeti i dorëzuar të jetë i regjistruar dhe i autorizuar për qarkullim sipas legjislacionit shqiptar, duke garantuar respektimin e kërkesave ligjore për përdorimin e mjeteve motorike në rrugët publike.

15. Mjeti duhet të jetë i mbuluar me garanci teknike dhe shërbimi për një vit nga dita e marrjes në dorëzim.

Argumentim teknik: Periudha e garancisë është kërkuar për të garantuar cilësinë e furnizimit, funksionimin normal të mjetit pas dorëzimit dhe mbrojtjen e interesit ekonomik të Autoritetit Kontraktor. Garancia redukton kostot e paparashikuara të mirëmbajtjes dhe siguron mbështetje teknike gjatë periudhës fillestare të përdorimit.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT